



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 29 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në Kishën e Shën Thanasit”, Pec, Delvinë.
2. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në Kishën e Shën Mërisë”, Kameno, Delvinë.
3. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në Kishën e Shën Thanasit”, Muzinë, Delvinë, duke respektuar variantin e rindërtimit të murit me teknikën origjinale.
4. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në Kishën e Shën Triadhës”, Kardhikaq, Delvinë.
5. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në rrënojat e Kishës së Shën Mëhillit”, Kostar, Mesopotam, Delvinë.
6. Miratimin e “Projekt i ndërhyrjeve emergjente në Shpellën me piktura”, Kostar, Delvinë.
7. Miratimin e “Projekt i strukturës së catisë, në bazë të studimeve dhe llogaritjes statike të kapriatës, për objektin Kisha e Shën Spiridhonit”, Vuno, Himarë.
8. Miratimin e “Projekt rikonstruksioni i banesës së Petro Markos”, Vlorë.
9. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
10. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

